



|   |                               |                              |                               |
|---|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar<br>Prenjshëm/Prodato<br>Received/Delivered | 29.12.2021                    | 1                            | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njesia<br>Organ./Jednica<br>Org./Unit                  | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtesa<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKPM/SHCK   | 6391/2021                     |                              | 113                           |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr. 940/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.940/2021 të datës 18.11.2021 të parashtruar nga \_\_\_\_\_ me adresë rruga "Arbnor e Astrit Dehari", Nr.21, Lagja e Spitalit në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "*Kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.940/2021 e datës 18.11.2021, e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me datë 17.11.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 5509/2021 të regjistruar me numër A.nr.940/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të organit të punësimit për refuzimin e kërkesës për lejimin e shfrytëzimit të reprezentacionit sipas Udhëzimit Administrativ 01/2008 për Caktimin e Shpenzimeve të Reprezentacionit për Zyrtarët e Institucioneve të Qeverisë së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.11.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli me datë 01.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 5509/2021 të regjistruar me numër A.nr.940/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 17.11.2021; Akt Emërimit e datës 21.05.2019 në emër të ankuesit; Vendimin e datës 12.04.2019; Vendimin e datës 20.05.2019; Urdhër Obligimin për Pagesë të datës 12.02.2020 dhe 05.02.2020; Kërkesën e datës 05.02.2020 dhe 10.02.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë te datës 24.11.2021; Përgjigjen në ankesë te datës 01.12.2021; Kërkesën përmes emailit te datës 20.10.2021 nga ankuesi për Përgjigjen e datës 25.10.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Kërkesën e datës 04.11.2021 te ankuesit për \_\_\_\_\_ Përgjigjen e datës 04.11.2021 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, \_\_\_\_\_ është e pa bazuar sepse:

Bazuar në provat e lëndës, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Me datë 20.10.2021, ankuesi përmes emailit zyrtar i është drejtuar Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me kërkesë për lejimin e shfrytëzimit të reprezentacionit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2008 për Caktimin e Shpenzimeve të Reprezentacionit për Zyrtarët e Institucioneve të Qeverisë së Kosovës, ndërsa me datë 04.11.2021 i njëjti është njoftuar nga organi i punësimit lidhur me refuzimin e kërkesës se tij.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, me datë 17.11.2021 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se organi i punësimit nuk po i njeh të drejtën e shfrytëzimit të reprezentacionit veprim ky ne kundërshtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2008 për Caktimin e Shpenzimeve të Reprezentacionit për Zyrtarët e Institucioneve të Qeverisë së Kosovës. I njëjti pretendon se i takon e drejta e shfrytëzimit te reprezentacionit sepse mban pozitën me të lartë në kuadër të Divizionit për Komunikim me Publikun pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhe se këtë të drejtë e ka shfrytëzuar gjatë kohës se ushtrimit të detyrës në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për njohjen e të drejtës për shfrytëzimin e reprezentacionit ka analizuar bazën ligjore të cilës i është referuar ankuesi, gjegjësisht dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2008 për Caktimin e Shpenzimeve të Reprezentacionit për Zyrtarët e Institucioneve të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht nenin 4 të këtij udhëzimi administrativ ku përcaktohet se: *Zyrtarët të cilët kanë të drejtë në shpenzime të reprezentacionit në kuadër të institucioneve të Qeverisë së Kosovës,*



janë: Kryeministri; Zv. Kryeministrat; Ministrat; Zv. Ministrat; Shefi i Kabinetit të Kryeministrit; Shefat e Kabinetit të Ministrave; Këshilltarët politikë; Sekretari i Përhershëm i ZKM-së; Sekretarët e Përhershëm; Kryeshëfat Ekzekutiv; Drejtorët e zyrave të ZKM-së; Drejtorët e Departamenteve si dhe Udhëheqësit më të lartë të organizatave buxhetore, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se pozita e udhëheqësit të divizionit, pozitë kjo e kategorisë së ulët drejtuese nuk hynë në kuadër të pozitave të punës për të cilat është përcaktuar e drejtat e shfrytëzimit të reprezentacionit.

Bazuar në konstatimin si me lartë dhe duke marr parasysh se ankuesi mban pozitën e udhëheqësit të divizionit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kolegji vlerëson se i njëjti nga ky pozicion i punës nuk mund të realizojë reprezentacionin mbi bazën e dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2008 për Caktimin e Shpenzimeve të Reprezentacionit për Zyrtarët e Institucioneve të Qeverisë së Kosovës, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.940/2021**

**Avdyll BEKTESHI**

*Avdyll Bekteshi*  
Procesmbajtës

**Jeton KOÇA**

*Jeton Koça*  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT);
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MINT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;